



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Xhevat Simnica Drejtor i Prokurimit në Komunën e Prishtinës
CC:	z. Shpend Ahmeti Kryetarë në Komunën e Prishtinës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Rekonstruimet dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në disa rrugë të qytetit dhe në Veternik dhe Shashkocv "



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Rekonstruimet dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në disa rrugë të qytetit dhe në Veternik dhe Shashkocv", me nr. të prokurimit: 616-13-187-521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin për tenderin "Rekonstruimet dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në disa rrugë të qytetit dhe në Veternik dhe Shashkocv" në Komunën e Prishtinës me numër të Prokurimit: 616-13-187-521, I inicuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës. Gjatë monitorimit të

kësaj procedure të prokurimit. Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të Prokurimit me që asnjëri nga OE pjesëmarrës nuk i plotësuan kriteret të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës më datë 04/11/2013 përmes ueb faqes së KRRP-së publikoi “Njoftim Kontrate”-Ritender këtë aktivitet të Prokurimit “Rekonstruimet dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në disa rrugë të qytetit dhe në Veternik dhe Shashkocvë ” – Ri-Tender, me nr. Prokurimi : 616-13-187-521 në Komunën e Prishtinës.

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare me një Njoftim të datës 12.11.2013, njofton Autoritetin Kontraktues –Komunën e Prishtinës se do të jetë pjesëmarrës në cilësinë e monitoruesit në këtë vlerësim të ofertave.

Komisioni vlerësues pas vlerësimit, ekzaminimit të ofertave rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, me që asnjëri nga OE pjesëmarrës nuk plotësuan kriteret të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt!